*Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës*

KATALOGU I EKSPOZITËS

# KOHA E SHNDËRRIMIT

Kosova 1968–1981: dokumente dhe dëshmi



*Prishtinë, Nëntor 2025*

ISBN 978-9951-404-64-8

AGJENCIA SHTETËRORE E ARKIVAVE TË KOSOVËS

# KATALOGU I EKSPOZITËS

## KOHA E SHNDËRRIMIT

Kosova 1968–1981: dokumente dhe dëshmi

Prishtinë, 2025

**Botues**
*Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës*

**Kryeredaktor i botimit**
*Bekim Aliu*

**Përgatitën**
*Raba Kelmendi*
*Fjolla Maloku Hamzaj*

*Dizajni grafik*
*Fjolla Maloku Hamzaj*

**Redaktor gjuhësor**
*Habibe Qovanaj*

**Tirazhi**
*100 copë*

# KOHA E SHNDËRRIMIT

Kosova 1968–1981: dokumente dhe dëshmi

Prishtinë, 2025

**Katalogimi në botim – (CIP)**
**Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"**

069.4:94(496.51)"1968/1981"
017:94(496.51)"1968/1981"

Katalogu i ekspozitës : koha e shndërrimit Kosova 1968–1981 : dokumente dhe dëshmi / kryeredaktor i botimit Bekim Aliu. - Prishtinë : Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës, 2025. - 36 f. : ilustr. ; 24 cm.

1. Aliu, Bekim

ISBN 978-9951-404-64-8

# PARAFJALË

Nga fundi i viteve 1960, Kosova nisi të fliste me zë më të plotë. Ajo që pëshpëritej në odë, në rrugë e në faqe dorëshkrimesh, nisi të dilte në dritë si kërkesë e hapur për barazi politike, gjuhësore e kulturore. Kjo nuk ishte diçka që lindi nga e para: për vite me radhë, rrjete të vogla studentësh e intelektualësh e kishin mësuar artin e durimit dhe veprimit në ilegalitet. Veprimtaria e Adem Demaçit — me libër, fjalë dhe dënim — u bë busull morale. Dosjet gjyqësore, konfiskimet dhe thirrjet hetimore krijuan një botë ku fjala e shkruar mbijetonte si strehë e lirisë, ndërsa organizimi i heshtur ishte mënyra e vetme për të mos humbur fillin.

Kthesa ndodhi më 4 tetor 1968: u pranua përdorimi publik i flamurit, një copë pëlhure që për shqiptarët në trojet e mbetura nën Jugosllavi peshonte sa një histori. Nuk ishte fundi i debateve, por fillimi i një gjuhe të re të të pasurit të drejtë, përfaqësim e prani. Pak javë më pas, më 27 nëntor, rruga u bë skenë. Studentë, punëtorë, mësues e qytetarë dolën me kërkesa të qarta: barazi, arsim shqip, nderim për simbolet. Fotot e kohës ende mbajnë frymën e asaj dite, me pankarta të shkruara me dorë, të cilat keni mundësi t'i shihni në këtë ekspozitë.Reagimi zyrtar lëvizi mes pranimit të pjesshëm dhe syrit vigjilent. Simbolika kombëtare u legjitimua, por kufijtë e fjalës dhe pjesëmarrjes mbetën të cunguar. Ky dyzim — hapje e kontrolluar dhe pritje në rritje — do ta shoqëronte gjithë dekadën.

Vitet 1969–1973 hapën një laborator të përditshëm kulture: shoqëri letrare, teatro, klube rinore dhe gazeta në gjuhën shqipe. U krijua një infrastrukturë e re komunikimi, ku fjala nuk fshihej më në sirtar. Ilegalja nuk u zhduk; thjesht humbi një pjesë të arsyes së ekzistencës, sepse argumentet po gjenin tribunë. U formua një brez autorësh, gazetarësh e organizatorësh që i dhanë publikut gjuhë, formë e guxim.

Megjithatë, kontrolli nuk u zhduk. Organe të posaçme vijuan të ndërhynin, sidomos kur arti i afrohej politikës. U krijua një ekuilibër i brishtë që duhej rinegociuar përditë: mes asaj që mund të thuhej dhe asaj që lejohej të dëgjohej.

Me Kushtetutën e vitit 1974, Kosova mori një kornizë të re brenda federatës: kompetenca më të gjera, përdorim zyrtar të gjuhës, organe vendimmarrëse të forcuara; pra teksti juridik u kthye në mjet pune. Kjo u pa në aktet e themelimit, vendimet administrative, programet mësimore dhe politikat kulturore. Për herë të parë, një pjesë e madhe e pritjeve të vitit 1968 kishte rrugë ligjore për t'u zbatuar. Por askush të mos mashtrohet, sepse asnjë kornizë nuk i shuan menjëherë tensionet. Premtimi i ligjit është gjithnjë më i shpejtë se kapaciteti i zbatimit, dhe kontrolli politik vijon të vërë kufij.

Vitet pasuese, 1974–1979, sollën rutinën e një normaliteti të ri. Universiteti i Prishtinës u bë vatër e formimit akademik. Institutet, muzetë dhe redaksitë punuan përditë në këtë drejtim. Ekrani publik hapi hapësira të reja fjalësh e figurash. Diplomimet e para, programet televizive, festivalet e botimet — të gjitha këto dëshmojnë lindjen e një elite kulturore dhe teknike. Sukseset u bënë të dukshme, por po ashtu edhe boshllëqet. Sa më shumë rritej pritja për përfaqësim real dhe mundësi të barabarta, aq më të prekshme bëheshin pengesat strukturore, burokratike e politike. Institucionet jo vetëm krijuan shanse, por edhe pasqyrë. Shoqëria filloi të masë, të krahasojë dhe të kërkojë mekanizma, e jo vetëm simbole.

Ndërkohë, mbikëqyrja nuk u fashit. Gjuha e gjykatave vazhdoi të shtrembëronte një spektër të gjerë të shprehjes politike. Pamfletet e konfiskuara, dosjet operative dhe burgosjet janë dëshmi që flasin qartë. Hapja kishte kufijtë e vet. Ilegaliteti mbeti bashkëbanues me institucionet, duke ruajtur rrjete alternative komunikimi dhe kujtese. Kjo dysi — normalitet institucional dhe kontroll politik — e shpjegon mirë pjesën e dytë të periudhës 1974–1979: si mund të veprohej ligjërisht sot dhe të pengoheshe nesër; si ishte e mundur që kultura të ishte njëherësh laborator lirie dhe objekt vëzhgimi.

Në fund të dekadës, 1979–1981, dy ritme u ndeshën kokë më kokë: ai i pritjeve shoqërore dhe ai i zbatimit institucional. Në universitete u shtuan masat disiplinore; në media u ashpërsuan polemikat; vendimet e ftohta administrative u lexuan si shenja ngushtimi.

Pakënaqësitë sociale, politike e kulturore u mblodhën në një nyjë. Demonstratat e vitit 1981 nuk ishin një rrufe në qiell të kthjellët, por epilogu i një dekade që kishte hapur dyer, pa ditur gjithmonë si t'i mbante ato të hapura.

Shpërthimi i vitit 1981 shënoi krizën e një projekti që premtoi shumë e arriti jo pak, por nuk arriti të ecë me ritmin e pritjeve. Kjo nuk e zhbën trashëgiminë e viteve '70; përkundrazi, e bën më të kuptueshme kompleksitetin e saj.

Çfarë mbetet? Së pari, dokumentet: proceset, aktet e themelimit, fletushkat, stenogramet, fotografitë, regjistrimet. Ato na lejojnë të rindërtojmë jo vetëm çfarë ndodhi, por edhe gjuhën me të cilën koha e kuptoi veten. Së dyti, përvoja: si simbolika bëhet procedurë, si pritjet matin institucionet, si një shoqëri kërkon të flasë në emër të vetes.

Kjo periudhë tregon se ndryshimi i qëndrueshëm ndodh kur tre shtylla ecin bashkë: simboli, ligji dhe praktika. Viti 1968 dha një moment të fuqishëm simbolik; viti 1974 një kornizë ligjore më të gjerë; ndërsa vitet pasuese ndërtuan kapacitete. Kur këto dalin nga sinkroni, krijohen boshllëqe që kthehen në kriza. Prandaj 1981 nuk është thjesht një datë protestash, por diagnoza e një asinkronie midis premtimit dhe përmbushjes.

Sot, kur u kthehemi këtyre ngjarjeve, mund të nxjerrim tre mësime të drejtpërdrejta: pa burime të shumta, historia rrezikon të ngurtësohet; pa institucione funksionale, simbolika mbetet e zhveshur; pa etikë në kujtesë (pa anonimizim kur duhet dhe pa kontekst për dokumentet e mbikëqyrjes), e kaluara shtrembërohet lehtë. Prandaj një ekspozitë për vitet 1968–1981 nuk është vetëm renditje faktesh: është ftesë për të parë se si shoqëria jonë u përpoq të bëjë paqe mes dëshirës dhe rregullit, mes hapjes dhe frikës. Dokumentet që shohim sot nuk janë gurë muzeu; janë dritare prej nga e shohim veten më qartë.

MA. Bekim Aliu

Prishtinë, 26.11.2025

# KOHA E SHNDËRRIMIT

Kosova 1968–1981: dokumente dhe dëshmi


Statuti i Lëvizjes Revolucionare të Bashkimit të Shqiptarëve

Pjesa e përgjithshme


Pjesa organizative



Dokument që shpreh zërin e shqiptarëve që ëndërronin bashkimin kombëtar, që tregon vendosmërinë dhe guximin për të mbrojtur trojet e mohuara dhe për të ndërtuar një të ardhme të lirë.

**Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës**
**Fondi: Gykata e Qarkut Prishtinë, viti 1964**


PROGRAMI I LËVIZJES REVOLUCIONARE TË BASHKIMIT TË SHQIPTARËVE

Çfarë karakter ka lufta jonë?

1. Karakter të bashkimit kombëtar.
2. Karakter të çlirimit kombëtar.







Program që pasqyron ëndrrat dhe luftën e shqiptarëve për të drejtat e tyre.
Reflekton pasionin dhe besimin e një brezi që nuk u dorëzua para shtypjes.

**Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës**
**Fondi: Gykata e Qarkut Prishtinë, viti 1964**



PREDSEDNIŠTVO I IZVRŠNI ODBOR POKRAJINSKE KONFERENCIJE SSRNS
ZA KOSOVO I METOHIJU

MAGNETOFONSKI SNIMAK

sa zajedničke proširene sednice Predsedništva i Izvršnog odbora Pokrajinske konferencije SSRNS za Kosovo i Metohiju, održane dana 4. oktobra 1968. godine u sali Socijalno-zdravstvenog veća Pokrajinske skupštine

(Neka pitanja u vezi isticanja zastava nacionalnosti)

Priština
4. oktobra 1968. godine



MAGNETOFONSKI SNIMAK

sa zajedničke sednice Predsedništva i Izvršnog odbora Pokrajinske konferencije Socijalističkog Saveza, održane dana 4. oktobra 1968. godine u sali Socijalno-zdravstvenog veća Pokrajinske skupštine.

Sednici predsedava Ilijaz Kurteši, predsednik Pokrajinske konferencije Socijalističkog saveza.

ILIJAZ KURTEŠI:

Otvaram Zajedničku sednicu Predsedništva i Izvršnog odbora Pokrajinske konferencije SSRN Srbije za Kosovo i Metohiju. Ovoj sednici prisustvuju neki članovi Izvršnog komiteta Pokrajinskog komiteta Saveza komunista Srbije za Kosovo i Metohiju, članovi Pokrajinskog komiteta, kao i drugovi Fadilj Hodža, Veli Deva, Dževdet Hamza, Ismailj Bajrami, drugarica Cica-Katarina Patrnogić i drug Sait Zatriqi.

Za ovu zajedničku sednicu predlažem samo jednu tačku dnevnog reda, a to je "Neka pitanja u vezi isticanja zastava nacionalnosti".

Da li ima ko neki drugi predlog dnevnog reda. (Nema). Da li ima ko kakvu dopunu predloženog dnevnog reda. (Nema).

Da li se slažete sa predloženim dnevnim redom. (Svi se slažu).

Pošto smo usvojili predloženi dnevni red, onda da predjemo na prvu tačku dnevnog reda.

Za ovu tačku dnevnog reda je sam pripremio jedno kratko uvodno izlaganje. U ovom mom uvodnom izlaganju su neki predlozi i o njima ćemo diskutovati.

Mbledhja e përbashkët e organeve krahinore më 4 tetor 1968, ku u diskutua për të drejtën e ekspozimit të flamurit shqiptar pas presioneve të vazhdueshme shoqërore.

Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës
Fondi: Lidhja Socialiste e Popullit Punues, viti 1968

3.

za Kosovo i Metohiju, neposredno posle IV Brionske sednice CK SKJ. Odredjeni organi Saveza komunista Jugoslavije su posle toga razmatrali probleme u vezi sa tim radi ujednačavanja stavova i prakse u celoj zemlji. Na jednoj od sednica Izvršni komitet Saveza komunista Srbije razmatrao je konkretne stavove i predloge koje je uputio Izvršnom komitetu CK SKJ koji je te stavove usvojio da sve narodnosti u sastavu SFRJ imaju pravo isticati svoje nacionalne zastave koji su izraz nacionalne pripadnosti.

Pre par dana održana je zajednička proširena sednica Izvršnog odbora Pokrajinske konferencije Socijalističkog Saveza i Izvršnog komiteta Pokrajinskog komiteta gde je bliže dogovoreno o načinu realizacije ovih stavova. Pošto je ovo jedno od krupnih pitanja iz oblasti realizacije nacionalne ravnopravnosti i ima uticaja na dalje unapredjenje medjunacionalnih odnosa - današnja sednica treba da utvrdi i objavi difinitivne političke stavove u vezi sa ovim pitanjima.

Potreba da se ova pitanja sada pokreću proizilazi iz činjenice što o upotrebi nacionalnih simbola u Jugoslaviji nije bilo jedinstvene prakse. U nekim delovima naše zemlje upotreba nacionalne zastave bilo je regulisano na odredjeni način. Na Kosovu i Metohiji je prekinuto sa upotrebom nacionalne zastave Albanaca i pored toga što su se u toku narodnooslobodilačke borbe i socijalističke revolucije i pod tom zastavom borili najbolji sinovi naroda Kosova i Metohije, pripadnici naroda i narodnosti.

8.

odnose i grade sebi bolju budućnost.

Pripadnici narodnosti u Autonomnoj Pokrajini doživljavaju punu afirmaciju u našoj socijalističkoj samoupravnoj zajednici kao aktivni subjekti i značajni faktori u regulisanju svih odnosa i društvenih poslova u Pokrajini. Pripadnici narodnosti na Kosovu i Metohiji, Albanci i Turci sve više ostvaruju pravo u upotrebi svog maternjeg jezika u javnom životu i opštenju sa društvenim organima i institucijama. Školovanje pripadnika narodnosti na svom maternjem jeziku postaje praksa od osnovnih do viših i visokih škola. Kulturni život na jezicima narodnosti poprima sve bogatiju sadržinu i nacionalni karakter a materijalna osnova razvitka tog života postaje sve stabilnija i bogatija. Pripadnici narodnosti već sada ravnomerno i proporcionalno svom učešću u ukupnom stanovništvu Kosova i Metohije učestvuju u predstavničkim telima svih nivoa i organa samoupravljanja radnih organizacija. Svakodnevno se poboljšava nacionalna struktura zaposlenih u Pokrajini u korist pripadnika narodnosti uz ulaganje ogromnih napora i sredstava za poboljšanje i kvalifikacione strukture pripadnika narodnosti sa tendencijom da ta struktura u bližoj perspektivi odgovara nacionalnoj strukturi stanovništva naše Pokrajine.

Stručni kadrovi iz redova pripadnika narodnosti kojih je u nedalekoj prošlosti bilo vrlo malo već sada predstavljaju snažan faktor bržeg privrednog razvoja kulturnog i društvenog razvitka Pokrajine i garanciju

Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës
Fondi: Lidhja Socialiste e Popullit Punues, viti 1968






Pamje që kapin energjinë dhe guximin e rinisë, zërin e atyre që u ngritën për liri, barazi dhe identitet, duke valuar flamurin kombëtar dhe duke ndezur flakën e ndryshimit në zemrat e të gjithëve.

**Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës**
**Fondi: Gjykata e Qarkut Prishtinë, viti 1968**






Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës
Fondi: Gjykata e Qarkut Prishtinë, viti 1968







Dëshmi të pjesëmarrjes masive të studentëve dhe qytetarëve më 27 nëntor 1968, një ditë që shënoi kthesë në kërkesën për të drejta kombëtare dhe përdorimin e simboleve shqiptare. Çdo pamje reflekton atmosferën e mobilizimit shoqëror, kur të rinjtë e Kosovës i dhanë protestës formën dhe forcën e një lëvizjeje historike për barazi dhe identitet.

**Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës**
**Fondi: Gjykata e Qarkut Prishtinë, viti 1968**






Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës
Fondi: Gjykata e Qarkut Prishtinë, viti 1968





NGA GJYQI I QARKUT NË PRISHTINË

U DENUAN ORGANIZATORET E DEMOSTRATAVE

NDERIME

E martë, 8.IV.1969

RILINDJA

Dokument shtypi që pasqyron ngjarjet e vitit 1968 dhe sakrificën e rinisë shqiptare.
Ai ruan informacion të rëndësishëm për kuptimin e kontekstit politik dhe shoqëror.

**Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës**
**Fondet: Gjykata e Qarkut Prishtinë, viti 1968;**
**Gazeta Rilindja**



# LUFTË E HAPËT E PA KOMPROMIS KUNDËR ELEMENTEVE SHOVINISTE E DESTRUKTIVE

Veli Deva

# ÇKA NDODHI NË PRISHTINË

## NË MBARË KRAHINËN BEFASI DHE DËNIM UNANIM I DEMOSTRATAVE

## KOMUNIKATA E DYTË E KËSHILLIT EKZEKUTIV KRAHINOR

KOMUNIKATË

MBLEDHJA E ZGJANUEME E KOMITETIT KOMUNAL TË LK TË PRISHTINËS

## Kundër çdo gjaje që pengon vllaznimin e bashkimin

RILINDJA E shtunë, 30.XI.1968 FAQE 7

Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës
Fondi: Gazeta Rilindja







Procesverbalet e Këshillit Ekzekutiv dokumentojnë diskutimet mbi shkaqet dhe masat ndaj demonstratave të nëntorit 1968.

**Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës**
**Fondi: Lidhja Socialiste e Popullit Punues**

INFORMATA
PËRKITAZI ME AKTIVITETIN E LIDHJES SOCIALISTE NË LIDHJE
ME NGJARJET E 27. NANDORIT TË VITIT 1968 DHE
DETYRAT E MATEJSHME

Aktiviteti mjaft i gjallë politik në Kosovë e Metohi, mbas demonstratave të 27. nandorit, ende po zhvillohet. Kjo informatë nuk ka për qëllim vlerësimin ma të plotë të gjendjes politike dhe aktivitetit të cilën e kanë ndërmarrë të gjitha fuqitë progresive shoqnore, por para se gjithash të vejë në pah aktivitetin politik të Lidhjes socialiste në këtë periodë, dukuritë të cilat i janë shprehë në kët aktivitet, problemet ideore e politike të cilat dalin nga këto ngjarje, dhe në detyrat e matejshme të zbatimit ma të plotë të qëndrimeve nga seanca e Kryesisë dhe e Këshillit ekzekutiv të Konferencës krahinore të LSPPS që u mbajtë me 1.dhetor.

Këto qëndrime kanë hasë në përkrahje të plotë ...
organizatat e Lidhjes socialiste në qytet e në fshatra, n...
lektivet punuese, ndër rini dhe intelektualë, me kërkesë ...
zbatohen në mënyrë konsekuente masat e karakterit politik ...
administrativ të cilat janë përmbajtë në to.

Nevojitet me theksue këtu reagimin e konferenc...
komunale të Lidhjes socialiste, këshillave të tyne ekzeku...
organizatave lokale dhe shoqatave, në përpjekjet e armiku...
shoqnisë sonë socialiste demokr-tike që me akcionet e orga...
me të realizojë qëllimet esencialisht të hueja qenies son...
nore. Këto organe, forume dhe organizata të Lidhjes social...
kanë tregue aftësi që të paraështrohen në mënyrë adekuate ...
atës së përcjellim me përpjekjet permanente të oponentëve ...
tik që të krijojnë mosbesim ndërmjet njerëzve.

2.-

Kështu në shumicën e komunave këshillat ekzekutive të Lidhjes socialiste në mbledhjet e veta dhe në konsultimet e përbashkëta të udhëheqësive të organizatave shoqnoro-politike me kohë e kanë caktue mënyrën e organizimit të informimit të qytetarëve mbi ngjarjet, e njikohësisht edhe shkëmbimet ma të gjana mendimesh mbi esencën e tyne, për luftën e matejshme kundër thyesëve të vllazënimit e bashkimit dhe protagonistëve politik të huej platformës së Lidhjes së komunistëve. Në të gjitha komunat theksohet se për përcaktimin ma të afërt e të çartë të detyrave të veta u kanë ndihmue me kohë materialet e dërgueme prej Komitetit krahinor të Lidhjes së komunistëve dhe Konferencës krahinore të LSPP, në të cilat janë paraqitë qëndrimet dhe Konkluzat në lidhje me demonstratat.

Në numrin ma të madh të komunave, mbas mbledhjeve të këshillave ekzekutive dhe aktivave politik, e edhe krahas me to, disa qendra, organizata lokale dhe shoqata, tue u sjellë në mënyrë inicijative, tashma janë deklarue për qëndrimet e Komitetit krahinor të Lidhjes së komunistëve dhe Konferencës krahinore të LSPP veçmas tue i përkrahë ato konkluza të cilat kanë të bajnë me nevojën e spastrimit konsekuent politik e administrativ me armiqët dhe pengimi që në arësim të ndikojnë personat të cilët i helmojnë marrëdhaniet ndërnacionale. Konkludim i shum organizatave asht që mbledhjet e ardhshme parazgjedhore të Lidhjes socialiste duhet të kanë edhe këto çeshtje në rendin e ditës, sidomos kur kemi parasysh se aktivitetet, sidomos ditëve të para, ma tepër i kanë përfshi kolektivet punuese, organizatat e Lidhjes së komunistëve, e diçka ma vonë asht fillue me sqarimin e këtyne ngjarjeve dhe asaj që qëndron në mbrapavijën e tyne dhe Lidhjen socialiste, sidomos në fshat. Tue pasë parasysh atë që në lokalitetet fshatare mjetet e informimit janë të varfuna, e me ky aktivitet në nji masë asht fillue me vonesë, kjo imponon nji aktivitet ma intensiv politik në Lidhjen socialiste në shlimin dhe sqarimin e të gjitha

Këto procesverbale zbulojnë mënyrën se si organet ekzekutive të Kosovës analizuan zhvillimet e demonstratave të nëntorit 1968, duke diskutuar arsyet e shpërthimit të tyre dhe masat që konsideroheshin të domosdoshme. Dokumentet ofrojnë një pasqyrë të qartë të tensionit politik dhe të përpjekjeve për të menaxhuar situatën shoqërore të kohës.

Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës
Fondi: Lidhja Socialiste e Popullit Punues

3.-

aspektëve të gjendjes politike të shkaktuame me demonstrata.

Në informatat të cilat kanë arrijtë prej organizatave komunale të Lidhjes socialiste, theksohet se si detyrë aktuale për punën e mtejshme asht parashtrue në aktivizimin e të gjithë anëtarëve në këtë proces mjaftë të hovshëm të ndarrjes së tendencave progresive prej atyne influencave të nacionalizmit të cilat synojnë me i tërhjekë mbrapa proceset e zhvillimit tonë shoqnor. Në këtë pikëpamje këto po ndihet angazhimi ma i madh i të gjithë aktivistëve në kolektiva dhe organizata ku po mbahen mbledhje me rastin e ngjarjeve të cilat mundem me shkaktue keqëpërdorime të ndryshme politike dhe dukuni tjera të nacionalizmit.

Konkludim i përgjithshëm nga shqyrtimet nga mbledhjet e deritashme asht se demonstratat kanë qenë klasore anmiqsore, antivetëqeverisëse dhe shoveniste dhe se asht i domosdoshëm aktiviteti i mtejëm ideo-politik i të gjitha forcave politike për izolimin politik, e për marrjen e masave administrative kundër bartësve të aktivitetit anmiqësor dhe thyesve të vllaznimit e bashkimit të popujve dhe kombësive tona.
Pranë kësaj duhet theksue se aktiviteti në Lidhjen s
asht pjesë përbase e mbarë aktivitetit shoqnoro-polit
forcave progresive dhe se në këtë aktivitet kujdesi i
asht përqëndrue në sanimin e gjendjes politike në Kr
evitimin e të gjitha pasojave të dAmshme të mundëshme
ne ngjarjeve sidomos në marrëdhaniet ndërnacionale.

Prej shum mbledhjeve të mbajtuna deri tash
jen socialiste vërehet dënimi mjaft i ashpër i platfo
aktorëve të demonstratave të paradokohshme si dhe dh
përkrahjes së plotë qëndrimeve të udhëheqësive Krahin
Lidhjes së komunistëve dhe Lidhjes socialiste. Njikoh
energjikisht kërkohet që të qëndrohet në këto qëndrim
zbulohen iniciatorët dhe bartësit e vërtetë të demon
dhe kundër tyne të mirren masa të ashpra politike e t

4.-

Poashtu, po vërehet bartja gjithnji e ma e gjanë e këtij aktiviteti ndër qytetarët dhe marrëdhania e tyne aktive ndaj detyrave prej nbarë këtij aktiviteti burojnë. Te kjo mendojmë se tubimet dhe mbledhjet e organizueme në organizatën e Lidhjes socialiste dhe në pjesëmarrjen e qytetarëve në punët e tyne nga rradhët e të gjitha kombësive.

Dënimi i demonstratave dhe dhenie e përkrahjes qëndrimeve të marruna politike në lidhje me to kanë ardhë prej qytetarëve të të gjitha kombësive në Krahinë. Në mënyrë mjaft të vendosun ka reague klasa punëtore, e së bashku me te edhe fshatarësija, rinia dhe inteligjenca. Në këte me rëndësi të veçantë asht reagimi i pjesëtarëve të kombësisë shqiptare, të cilët energjikisht kërkojnë që shoqnia jonë pa kompromis të qërojë hesapet me forcat anmiqsore të cilat i kanë organizue demonstratat.

Aktiviteti i këtillë mjaft pozitivisht asht shprehë edhe në gjendjen dhe disponimin politik të qytetarëve dhe në gatishmëninë e tyne që t'i kundërshojnë përpjekjeve të ndikimit anmiqsor prej kahdo ana që të vijë ai. Kjo do t'i kontribuonte normalizimit të shpejtë të jetës shoqnore e politike në vendet në të cilat ka ardhë deri te demonstratat, si dhe marrjen e masave përkatëse për evitimin e pasojave politike e të tjera të këtyne ngjarjeve në Krahinë.

Edhe përveç përpjekjeve të pengimit të rregullitë të zhvillimit të mësimit në shkolla e në fakultete, ai zhvillohet normalisht, që asht fakt i aktivitetit të gjallë politik në zbatimin e qëndrimeve dhe konkluzave të Lidhjes së komunistëve dhe Lidhjes socialiste në organizatat arësimore e të tjera.
Te të gjithë këta asht e prenishme përkrahje politikës së Lidhjes së komunistëve mbi barabarësinë kombëtare dhe gatishmëninë për luftën vendimtare kundër të gjithë thyesve të bashkimit e vllaznimit, kundër të gjitha dukunive dhe tendencave nacionaliste dhe shoveniste.

Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës
Fondi: Lidhja Socialiste e Popullit Punues

- 8 -

8

III. LËMA E ARËSIMIT, SHKENCËS DHE KULTURËS

1. Si çështje të reja në këtë program të shenohen edhe këto:

- problemet aktuale të jetës muzikore në Krahinë,

- problemet aktuale të jetës së artit figurativ në Krahinë /këto dy çështje janë shenuar në vend të çështjes nën pikën 155 "Problemet aktuale dhe zhvillimi i mëtejshëm i krijimtarisë artistike në Krahinë.

- Programi i mbrojtjes së monumenteve të kulturës gjer në vitin 197o / në vend të temës së propozuar në Projektin e programit nën pikën 14. "Problemet aktuale të mbrojtjes së trashëgimit kultural në Krahinë"/.

-Programi i zhvillimit të televizionit në Kosovë,

- problemet e shtypit në Krahinë,

- Propozimi i Ligjës mbi themelimin e Univerzitetit në Prishtinë,

- Propozimi i ligjës mbi formimin dhe konstituimin e bashkësisë krahinore të veprimtarisë botuese dhe mjetet e informimit publik,

- Propozimi i ligjës mbi grumbullimin dhe ndarjen e mjeteve për kinofitimin në Krahinë,

- Harmonizimi i dispozitave krahinore nga lëma e arësimit, shkencës dhe e kulturës me Ligjës kushtetuese të KSA të Kosovës.

2. Në program të shenohen edhe këto çështje.

- Informata mbi mundësitë e regjistrimit të nxënsëve dhe studentëve në vitin shkollor 1969/197o,

- standardi i studentëve të shkollave të larta dhe të fakulteteve në Krahinë /kjo çështje do të përfshihet nëpërmes të çështjes tjetër/,

- realizimi i përfundimeve mbi çështjet aktuale të zhvillimit të mëtejshëm të shkollave të larta dhe të fakultetev në Krahinë,

Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës
Fondi: Kuvendi i Krahines Socialiste Autonome e Kosovëss



për manifestimet e ndryshme, për angazhim sa më të madh që të depërtojë libri edhe atje, ku deri tani është ndjerë mungesa e tij. Të gjitha këto e të tjera kishin për qëllim rritën e kulturës sonë, — depërtimin e librit, sidomos nëpër fshatra, pasi atje më tepër se askund ndihet nevoja dhe domosdoshmëria për kontaktim me të. Mirëpo, me keqardhje duhet të konstatojmë se të gjitha ato manifestime mbetën vetëm të shënuara në letër e asgjë më shumë. Pos kësaj, patëm shkruar se do të hapen biblioteka të reja, e ato që ekzistojnë duhet të pajisen më shumë se asnjëherë me libra, se do të mbahen mbrëmje të ndryshme letrare, se do të hapen ekspozita të librit, por prej të gjithave përsëri pak është ndërmarrë, për të mos thënë aspak.

Pra, edhe një herë po themi, edhe pse një gjë e tillë dihet, se ky pasivitet kultural do të na kushtojë shtrenjtë, e aqë më tepër meqë „Muaji i librit" sivjet u mbajt në kuadër të Vitit ndërkombëtar të librit. Me fjalë të tjera, ishte moment shumë i volitshëm për ne, që t'jau afrojmë sa më tepër librin lexuesve, të hapim biblioteka të reja, sidomos nëpër fshatra, në mënyrë që sado pak të zgjerojmë rrjetën e bibliotekës sonë, përndryshe të pazhvilluar.

NGA KONGRESI I DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE

## PROBLEMET THEMELORE TË DREJTSHKRIMIT—NË SHQYRTIM

Tiranë, 20 nëntor

**Në sallën solemne të Kuvendit popullor, sot filloi punën Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe, që do të zgjasë gjer më 25 të këtij muaji. Kongresin e hapi THOMA DELIANA, ministër i arësimit dhe kulturës, i cili në fjalën e rastit, pos funksionarëve, përshëndeti edhe delegatët nga Jugosllavia e Italia.**

Kongresi nisi punën me referatin kryesor „Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshkrimit të saj", të cilin e lexoi prof. *Androkli Kostallari.*

Profesor Kostallari, midis tjerash, vuri në dukje se duke u zhvilluar gjatë shekujve sipas nevojave e kërkesave të shoqërisë, gjuha e shkruar shqipe, në lidhje të pandërprerë me gjuhën e folur popullore, ka arritur tash të bëhet një gjuhë letrare kombëtare në kuptimin më të plotë të fjalës. Kjo është formë më e lartë në jetën e gjuhës shqipe. Një nga kërkesat themelore të kësaj forme është edhe drejtshkrimi i unisuar, pjesa përbërse më e dukshme e normës letrare kombëtare.

Profesor Kostallari vuri gjithashtu në dukje se shqiptarët që banojnë në Jugosllavi në të gjitha veprimtaritë shoqërore, kulturale e shkencore, në gjini të ndryshme të letërsisë artistike, me sukses po aplikojnë gjuhën letrare shqipe dhe drejtshkrimin e ri. Në këtë gjuhë të përbashkët në Kosovë është botuar një letërsi shumë e gjerë dhe e larmanshme në të gjitha fushat me një vlerë

shquar artistike, gjë që dës
mon si për gjerësinë, ash
dhe për thellësinë e përv
tësimit të normës letrare k
mbëtare dhe të përgjithshm
njerëzore.

Në seancën e dytë, që zh
lloi punën gjatë orëve të pa
ditës, kumtesat e tyre i l
xuan: prof. Mahir Domi „P
rimi fonetik në shkrimin
shqipës", prof. Eqrem Çab
„Mbi disa çështje të tradit
së shkrimit dhe të drejtshk
mit të shqipes", dr. Idriz Aj
ti „Rruga e zhvillimit të gj
hës letrare shqipe në Kos
vë", prof. Bedri Dedja „Rret
akselerimit dhe ndikimit t
tij në mësimin e gjuhës letra
re", prof. Dhimitër Shuteriq
„Shkrimtarët dhe drejtshkr
mi", mr. Remzi Nesimi, ng
Shkupi „Mbi procesin e nj
simit të drejtshkrimit t
shqipes letrare në Maqedoni
dhe Anastas Dodi „Mbi m
rrëdhënjet e drejtshkrimi
dhe të drejtshqiptimit".

Ibrahim KADRIU

RILINDJA

E MARTË, 21. XI. 1972

Ngritja e institucioneve u bë përditshmëri e jetës publike: universiteti, teatro, muze, arkiva, ansamble, redaksi, shtëpi botuese. Ato krijuan skenë, prodhuan dije, formuan profesionistë dhe i dhanë publikun një gjuhë të përbashkët shijeje e debati. Programet vjetore, sesionet shkencore, festivalet, ekspozitat dhe botimet nuk mbetën në letër: sollën audienca të reja, rrugë pune për artistë e studiues, fonde dokumentare që sot janë bazë kujtese.

**Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës**
**Fondi:: Gazeta Rilindja**

NGA KONGRESI I DREJTËSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE

# U PARAQITËN RAPORTET MBI PUNËN E DY SEKSIONEVE

Tiranë, 23 nëndor

Afro 20 vetë sot lexuan punimet e tyre nga aspekti i drejtshkrimit të zanoreve dhe të bashkëtingëlloreve si dhe nga aspekti gramatikor i shkrimit të fjalëve që këto dy asepkte përbëjnë punën e përgjithshme të dy seksioneve të këtij kongresi. Përndryshe, me këto punime që u lexuan sot përfundoi puna në këto seksione.

Si në atë të parin, poashtu edhe në seksionin e dytë materialet qenë interesant e në mënyrë shkencore dhanë kontribut në përforcimin e nevojës për gjuhën e unisuar. Në seksionin e parë u lexuan këto tema: „Mbi shkrimin e fjalëve të huazuara nga latinishtja" i bashkëpunëtorit të vjetër shkencor Pashko Geci, pastaj „Mbi shkrimin e fjalëve të huazuara nga greqishtja" i autorit Stefan Prifti, „Mbi disa çështje kryesore të drejtshkrimit të fjalëve të huazuara nga gjuhët romane" i Fadil Podgoricës dhe „Mbi shkrimin e fjalëve të hueja që kanë në kontekst të ndjekur nga I O nga Kol Asthta. Xhevat Lloshi paraqiti kumtesën „Çështje të drejtëshkrimit të emrave të përveçshëm nga gjuhët sllave". Kësaj teme iu bashkangjit edhe dr. Latif Mulaku i cili paraqiti disa shembuj konkretë të homonimeve dhe të toponimeve sllave që janë futur në gjuhën e sotme shqipe. Në këtë seksion u lexuan edhe disa punime të tjera të cilat gjithashtu paraqesin vlerë të posaçme.

Në seksionin e dytë të paraditës sot u lexuan edhe këto punime: „Mbi përdorimin e shkronjeve të mëdha në titujt e librave, gazetave, revistave dhe në emërtimet e veprave të artit e në monumentet historike" i autorit Dhori Qirjazit, pastaj tema e veçantë „Përdorimi i shkronjeve të mëdha në emrat gjeografikë të përbërë" e autores Sopika Morska etj.

Sot, paradite u dhanë raportet e komisioneve të cilat, veç e veç paraqiten rezultatet e përfundimit të punës në seksione.

Kongresi nesër vazhdon punën me diskutime dhe me aprovimin e projektrezolutës së Kongresit.

I. KADRIU

E PREMTE, 24. XI. 1972

RILINDJA

NGA KONGRESI I DREJTËSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE

# PROJEKTREZOLUTA APROVOHET NJËZËRIT

**U vunë në pah edhe një varg propozimesh e sygjerimesh për përmirësimin e plotësimin e mëtejmë të rregullave të drejtshkrimit**

Tiranë, 24 nëndor

Sot pasdite vazhduan diskutimet mbi drejtshkrimin e gjuhës shqipe që mbrenda filluan pas raporteve të komisioneve që ishin të caktuara të vlerësojnë punën e dy seksioneve.

Raportet e mbrëmshme mbi punën e komisioneve bënë me dije të pranishmit mbi suksesin e Kongresit plotësisht në saje të kumteseve të shumta e të udhëhequra. Parashtresën e paraqitur nga komisioni i seksionit të parë që u muar me problemet e drejtshkrimit të zanoreve dhe të bashkëtingëlloreve e dha docenti *Anastas Dodi* i cili ndër të tjera tha edhe këtë: në këtë seksion, fjala është për seksionin e parë të Kongresit në të cilin u mbajtën 57 kumtesa e diskutime nga gjuhëtarë, studjues, shkrimtarë, mësues e punonjës të tjerë që janë të lidhur me zbatimin e gjuhës letrare shqipe dhe të drejtëshkrimit të saj. Kumtesat e diskutimet e zhvilluara i sollën Kongresit një mendim më të shëndoshë e objektiv, sollën kërkesat e praktikës gjuhësore, të shkollës e të shtypit, e këto, pa dyshim, do t'i bëjnë rregullat e ardhshme të drejtëshkrimit më të përsosura e më të qëndrueshme. Duke përkrahur konceptet e projektparimet themelore e zgjidhjet kryesore të projektit të „Rregullave të drejtëshkrimit të shqipes" të vitit 1967, ato sollën në të njëjtën kohë vërejtje e propozime të rëndësishme për shumë çështje të veçanta, të cilat përbëjnë një kontribut të çmuar për përpunimin dhe hartimin përfundimtar të „Rregullave të drejtëshkrimit të shqipes". Nga gjitha kumtesat dhe diskutimet në këtë seksion doli se të pranishmit janë të mendimit që parimi kryesor i drejtëshkrimit të shqipes duhet të jetë parimi fonetik. Ky argumentohet me mundësitë që na jep sistemi fonetik morfologjik i shqipës, në traditën e drejtëshkrimeve tona dhe me synimin për të vendosur një lidhje të ngushtë midis formës së shkruar dhe trajtës së folur të gjuhës letrare. Parimi fonetik do të zbatohet në të gjitha rastet kur shqiptimi letrar paraqitet i njësuar. Por krahas parimit fonetik do të zbatohet edhe parimi morfologjik.

Në emër të komisionit të dytë që trajtoi çështjet gramatikore, shkrimin e fjalëve bashkë dhe ndaras, përdorimin e shkronjave të mëdha e të tjera e lexoi parashtresën profesor *Mahir Domi*. Ky ndër të tjera i njohoi të pranishmit edhe me këtë se punimet e këtij seksioni u zhvilluan në një atmosferë pune intensive. Referimet e mbajtura në këtë seksion miratuan në vija të përgjithshme parimet kryesore të projektit të „Rregullave të drejtëshkrimit të shqipes", si dhe pjesën dërmuese të zgjidhjeve, që përmban ky Projekt, njëkohësisht aty gjetën miratim edhe tezat themelore të referatit që u mbajt në Kongres. Mendimi i kumtesave ishte se Projekti i rregullave të drejtëshkrimit botuar më 1967 ishte një ngjarje e madhe për gjuhësinë tonë letrare. Ky projekt jo vetëm që gjeti zgjidhje që i përgjigjeshin realitetit objektiv e prirjeve më të përgjithshme të gjuhës sonë letrare, por si ishte edhe një kontribut i drejtpërdrejtë për kristalizimin e normës letrare në këtë gjuhë.

Pas diskutimeve, sonte nga delegatët u aprovua njëzërit Projektrezoluta e Kongresit e që nesër kjo rezolutë do të nënshkruhet nga delegatët me rastin e përfundimit të Kongresit.

I. KADRIU

10

E SHTUNË, 25. XI. 1972

RILINDJA

Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës
Fondi:: Gazeta Rilindja



Krahina Socialiste Autonome e Kosoves
KESHILLI EKZEKUTIV I KUVENDIT TE KSAK
SEKRETARIATI PER MARREDHENIE ME
BOTEN E JASHTME
Ol.Numer: 27-54/74
Prishtine,20.XI.1974

Teper Rezervat

Bashkangjitur me aktin po u dorezojme materialin mbi marredheniet me RP te Shqiperise, te dedikuar Kryesise se Krahines, me lutje që t'i jipni sugjerimet dhe verejtjet tuaja paraprake, ne fryme e marreveshjes se perbashket mbi pergaditjen e ketij materiali.

Per shkak te urgjences se shqyrtimit te tij nga ana e Kryesise luteni qe te gjeni kohe per konsultim te perbashket gjate di... tes se neserme, ne kohen qe do t'a caktoni ju vet.

SEKRETARI,
Ukshin Hoti





Në sfidat e politikës ndërkombëtare, Kosova tentonte të gjente vendin e vet dhe të kontribuonte për bashkëpunim. Çdo paragraf tregon përpjekjen për të ruajtur identitetin dhe dinjitetin kombëtar.

**Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës**
**Fondi: Sekretariati Kranihor per Mardhenie me Botën e Jashtme**

3.-

Podvlačio je spremnost Albanije da sa njenog teritorija ne dozvoli napad na Jugoslaviju. Istovremeno je naglasio nezavisnost Jugoslavije, Albanije, i Grčke, za koje je rekao da ne samo "što žive bez Varšavskog ugovora i NATO-a, nego one žive slobodne i nezavisne".

Mehmet Šehu 30 oktobra je konkretizovao Enverov govor. On je rangirao zemlje sa kojima Albanija održava odnose, rekavši da Albanija održava prijateljske veze i saradnju sa socijalističkim zemljama, ukazavši na DR Koreju; sa Vijetnamom; dok je NR Kinu posebno izdvojio kao zemlju sa kojom održavaju prijateljske veze internacionalističke pomoći i saradnje. Nas je stavio u [illegible] medjunarodnih odnosa NR Albanije. Rekao je da s nama održavaju "odnose normalne medjudržavne saradnje", sa [illegible] obostrane koristi i nemešanja u unutrašnje stvari. [illegible], podsetio je principe na kojima se ova saradnja zasniva.

Istovremeno, je podvlačio spremnost da se ovi odnosi prošire, na pitanjima od zajedničkog interesa.

Ono što je važno u ovim govorima se odnosi na činjenicu da se Jugoslavija apostrofira od kapitalističko-revizionističkog okruženja NR Albanije. Pravda govore o revizionizmu uopšte, pomno su stavili do znanja da se ne računaju da [illegible] oponent.

Sa naše strane, [illegible] je u DSIP-u, Albanski ambasador u Beogradu, kome je izražena naša pozitivna reakcija na ovo govore koji se odnosio na nas.

Drug Milan [illegible] iz DSIP-a je u izjavi za štampu ~~je takodje~~ pozitivnu ocenu dao Enverovog govora koji se odnosio na nas i rekao da će Jugoslavija [illegible] inicijativu na saradnju.

4.-

Zatim je drug M.Minić, u svom govoru u Saveznoj Skupštini, okarakterisao pozitivno odnose sa NR Albanijom, rekavši da se oni kreću uzlaznom linijom.

Podvlačio je našu trajnu zainteresovanost i spremnost za razvoj saradnje sa NR Albanijom.

"Zëri i Popullit" je u celini preneo ovaj deo govora druga M.Minića, izuzev rečenice koja se odnosi na to da smo bili i ranije zainteresovani za razvoj ovih odnosa i one kojom je izražena nada za potpisivanje Programa Kulturne saradnje sa NR Albanijom.

Jugoslovensko-albanski odnosi, zapravo se zasnivaju i na nekim elementima trajne prirode kao što su geopolitički i strateški položaj naših zemalja; slični uslovi vodjenja narodnooslobodilačkih borbi i revolucionarnog rata; zajednički i strateški ciljevi ekonomskog i političkog razvoja obeju zemalja i faktor albanskog stanovništva u Jugoslaviji.

Geopolitički položaj je usko povezan sa kretanjima na medjunarodnoj sceni.

Supersile se nisu odrekle svoje politike sila, što potvrdjuje njihovo konkretno ponašanje u svetu.

S druge strane energetska kriza koja je od prošle godine zahvatila svet, unela je niz novih elemenata u celokupne medjunarodne odnose koji se reflektuju i na ovaj deo Balkana. Vrši se pritisak na proizvodjače nafte da ne povećavaju cene. One, [illegible] prete i direktnom upotrebom sile, ali najviše indirektno izazivaju kriza kao na Cipru ili održavanja stanja ni rata ni mira, kao na primer na Bliskom Istoku i konačno vrše pritisak da [illegible] kod evropskih proizvodjača da snize cene nafte.



- 2 -

sulmet e saj te policise me pake do te demtojne veprimtarin dhe radhet tona, ato do te na sherbejne ne metodat e konspiracionit t'i persosim edhe ne nje shkalle me te lart.

Celula e jone duhet te jete e afte te perballoj gjithe perpjekjeve te policise dhe agjentve te saje, te ruaj forcen dhe vitalitetin evet revolucionar. Qe te arrihet kqo, celula e jone duhet te veproj me perpikri te madhe ne punen e vet ilegale, shpirti i se cilES eshte konspiracioni, ajo mund t'ia arrije qellimit te saje duke iu permbajtur udhzimeve vijuese te cilat jane rezulyay i pervojes sone modeste dhe pervojes se shum partive e levizjeve revolucionare te botes.

UDHZIME PER SJELLJEN E ANTARVE TE CELULES NE PERGJITHSI

1.- Antari i celules tone ilegale, nuk guxon te dallohet nga rrethi i tije as per nga vesha dhe as per nga cendrimi; nuk guxon te baje veshje te dalluar "revolucionare", "patriotike", amblene te ndryshme etj. te flas per revolucionin dhe organizimin gjithku dhe ne çdo vend.

2.- Si antare i celules nuk guxon t'u tregosh shokve se ke lidhje me ndonje shok ose celule tjeter me te cilen ke filluar te punosh me pare. Per veprimtarine tende politike nuk guxon te dije as familja madje as shoqja e jote e jetes.

3.- Shoket qe jane nen kontrollin e policise (qe percillen nga ajo ose qe kane rene ne sy) mos i pershendet ne rruge dhe mos rri me ta ne vende ku mund t'ju shoh dikush, sepse do te bish ne sy edhe ti.

4.- Shoket e punes nuk guxon ti dije askush, takimet eps natyrshme me te qofte edhe te aferm familjarishte ndalohet rreptesisht.

5.- Mos mbaj prane vehtes letra e adresa te komprimituarish, ditar etj. Duhet qe adresat ti mbash mend, ose t'i shenosh me simbole te caktuara, por ne menyre qe ato ti arsyetosh me ndonje llogari tenden. Adresat dhe rruget duhen te mbahen mire mend qe per çdo eventualitet te mos pyetish kerkend.

6.- Gjate bartjes se materjalit ilegal si libra, afishe etj. sherbehu me persona neutral, dhe per çdo rast jij i gatshem qe ta zhdulish, qe te mos bjer ne dore te policise. Kur ke me vete ndonje leter pusulle etj. dhe te kercnohet rreziku ate duhet edhe ta gelltisesh..

7.- Mos mbaj ne banese dhe shtepi kurrfare materiali komprimitues, dokumente literatur ilegale etj. Duhet te kesh gjithnje parasyshe kontrollimin ose arrestimin dhe mos harro qe vendbanimi i yt te jete gjithnje i "paster", kur dihet se policija nuk la vend pa i futur hundet. Gjerat ilegale duhet meshehur jashte shtepise, atje ku nuk ~~zbulohet rrezikohet zbulohet~~ rezikohet zbulimi i tyre.

8.- Nese ke pasur mundesi dhe sukses qe te jeshe i pa njohur per policine si revolucionar, athere mos mbaj ne banes as literatur e as gjera te tjera me karakter revolucioner, ne menyr qe policia te mos dyshoj ne ty.

9.- Gjate ose pas kryrjes se ndonje akcioni ose detyre, nuk guxon t'u tregosh shokve se ke bere kete ose ate gje, per detyten (akcionin) e kryer duhet te dijne vetem shoket qe eshte e nevojshme te dine. Aqe me pak nuk guxon te lavdrohesh.

10.- Gjate kryrjes se ndonje akcioni ose detyre, ~~nuk guxon ta tregosh~~ gjate ikjes etj. jij shum i kujdesshem nese dikush percjon perapesh, sjellja e jote duhet te jete shum e natyrshme, te mos ia vrass syrinas kalimtarit te rastit.

11.- Çdo antare i celules tone tek i cili per arsye te pakujdesi, nenvleftsimi te armikut ose punes se pamjaftuar konspirative, nese gjate kontrollit ose arrestimit policia zbulon gjurma te punes organizative, eshte nje lloj tradhetie dhe duhet qe si kur te dal ne liri te merret ne pergjegjesi per leshimet e veta te çfardo natyre qofshin ato.

-II-

PER MBAJTJEN E TAKIMEVE

1.- Per vendin e mbledhjes ose takimit te celules, duhet te dijne vetem antaret e saje, ai (vendi) nuk duhet te jete fare i rene ne sy te policise, aty duhet vene edhe sinjalet e caktuara qe duken nga larg, nese vendi eshte i lire, apo ne te kunderten nese aty eshte verejtur ndonje njeri i dyshimt,

Mjetet e ilegales për shpërndarjen e materialeve të fshehta informuese dokumentojnë metodat e organizimit të lëvizjeve ilegale dhe komunikimin jashtë strukturave zyrtare.

**Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës**
**Fondi: Gjykata e Qarkut Prishtinë, viti, 1964s**



13.-Zastava istaknuta noću izmedju 12 i 13 aprila 1964 godine na grobu Šaban Šalje u selo Letance,istaknuta od strane okrivlj. Memeti Envera,studenta iz sela Sibovca.Veličina zastave: 90 x 140 sm.



1.-Tehnička srestva organizacije"LRBŠ":pisaća mašina;šapilograf; drveni i papirni kofer;zastave i dr.

Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës
Fondi: Gjykata e Qarkut Prishtinë,viti,1964s



3.-Unutrašnji izgled sanduka u kome je nadjena pisaća mašima i dr. [illegible] neprijateljske organizacije,opisan pod brojem 2.



6.-Unutrašnji izgled šapirografa,opisanog pod tačkom broj 5,sa kompletnim priborom.

Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës
Fondi: Gjykata e Qarkut Prishtinë,viti,1964s



Date 12 nentor të vitit 1975
PRISHTINË

HK/ASH

K. 239/75
12. XI 1975.
ПРИШТИНА — PRISHTINË

GJYKATËS SË QARKUT

PRISHTINË

Konform nenit 44 lidhur me nenin 240, nenin 241, nenin 242 të Kodit të procedurës penale, parages

A K T A K U Z Ë

Kundër:

1. ADEM DEMAQIT, student i vitit të III-të të Drejtësisë me korospodencë nga Prishtina rr. Zenel Hajdini nr.18, u lind më 26 shkurt të vitit 1936 në Prishtinë, i biri i Zeqirit e i Nazmijes, e gjinisë Halimi, shqiptar, shtetas i RSFJ, i ç'kurorizuar, baba i 2 fëmijëve, më parë ka kryerë gjimnazin real në Prishtinë, i paaftë për kryerjen e shërbimit ushtarak, është në EU pranë KK-së Prishtinë, gjindët në paraburg prej dt. 6 tetor të vitit 1975, më parë i gjykuarë për krim nga neni 117 al. 1 lidhur me nenin 100 e 101 të KP. me aktgjykimin e Gjykatës së qarkut në Prishtinë P.nr.271/64 të dt. 1 shtator të vitit 1964, i gjendjes së varfur ekonomike,

2. SKENDER KASTRATI, ekonomist i diplomuarë nga Prishtina – rr. Genimete Tërbeshi nr.19, u lindë më 15 janar të vitit 1947 në Koraqevi, i biri i Bra[…] Sabiles, e gjinisë Shabani, shqiptar, shtetas [...] pa martuar, obligimin ushtarak nuk e ka rregu[…] gjendjes së mesme ekonomike, është në paraburg[…] majit të vitit 1975, më parë i gjykuarë me ak[…] Gjykatës së qarkut në Gilan P.nr.23/69 dt. 16 […] vitit 1969 për krim nga neni 118 al. 1 të KP. […] burg,

3. HETEM BAJRAMIT, arsimtarë nga Pris[…] e Llapit nr.14, u lindë në Gilan më 12 dhjeto[…] 1946, i biri i Ejupit e i Akiles, e gjinisë R[…] ptar, shtetas i RSFJ, i pa martuar, ka kryarë […] lartë teknike, obligimin ushtarak e ka rregul[…] 1969 në Nikshiq, gjindët në EU pranë KK Gilan […] së mesme ekonomike, është në paraburg që nga […] tor të vitit 1975, i gjykuarë më parë me aktg[…] Gjykatës ushtarake në Sarajevë LK.nr.84/69 dt[…] për krim nga neni 118 al. 1 dhe nga neni 342/[…] me 4 vjet e 3 muaj burg të rëndë,

./.



19. NAZIM [illegible], arsimtar nga Gilani, rr."7 Korriku" nr.44, u lindë në fshatin Kolickë më 11 gusht të vitit 1950, i biri i Ramizit e i Zahtëhanes, e gjinisë Drogobugja, shqiptar, shtetas i RSFJ, i pamartuar, obligimin ushtarak nuk e ka rregulluar, i gjendjes së varfur ekonomike, është në EU pranë KK Gilan, nuk është i gjykuarë, është në paraburg prej dt. 15 maj të vitit 1975,

S E P S E

A/ Të pand. Adem Demaqi, Skender Kastrati, Hetem Bajrami, Hasan Dërmaku, Osman Dumoshi, Rexhep Mala, Selatin Novosella, Ilaz Pireva dhe Fatmir Salihu:

për të kryerë vepra penale kundër popullit dhe shtetit, me forcë apo në mënyrë tjetër kundërkushtetutare të ndërrojnë pushtetin e popullit punonjës, të shkatërrojnë unitetin e kombeve e kombësive të Jugosllavisë, e veçanërisht për ta ndarë Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës e vendet tjera të banuara me shqiptar nga RSFJ, vepruanë si organizator në grupin armiqësor të formuarë në gjysmën e parë të vitit 1973, të cilin në dhjetor të vitit 1974, në takim në shtëpinë e Skender Kastratit në Prishtinë e pagëzuan me emrin "Lëvizja nacionalçlirimtare e Kosovës" i cili ka mbajtur shumë takime, ka punuarë në zhvillimin e veprimtarisë armiqësore për përfitimin e antarëve të rinjë, për organizimin dhe shpërndarjen shpeshherë të shumë afisheve dhe shkruarjen e parullave me përmbajtje armiqësore në Prishtinë, Hogosht, Toponicë, Presheve e Orahovicë, e përveq tjerash edhe këte:

I. Adem Demaqi,

gjersa ishte në vuajtjen e dënimit në Pozharevc, për shkak se më parë e ka formuarë grupin armiqësor të ashtuquajtur "Lëvizja revolucionare për bashkimin e shqiptarëve", bisedojë me Hetem Bajramin e Selatin Novosellën – në kohë prej shtatorit të vitit 1969 gjer në mars të vitit 1973 e dha iniciativën për të vazhduarë veprimtarinë armiqësore kundër RSFJ duke i udhëzuar se në ç'mënyrë duhet të bëhet organizimi, se cilën literaturë duhet lexuarë për të gjetur principin e veprimit, se duhet formuarë grupe nga njerzë të cilët së pari duhet përfituarë, foli për të drejtën e vetëvendosjes, e pasi dual nga vuajtja e dënimit, në shtëpi të vet në Prishtinë e vende tjera u takua me Skender Kastratin, Hetem Bajramin, Hasan Dërmakun, Osman Dumoshin, Rexhep Malen, Selatin Novosellen, Ilaz Pirevën, Xhavit Dërmakun e Adem Rukiqin, për të cil[…] [illegible] se janë kundërshtar të rëndit shoqëror e shtetëror të Jugosllavisë të cilëve gjatë vitit 1974 e 1975 u tha që të angazhojnë përsona të rinjë për veprimtari të cilët nuk janë të "komprimituarë", se këta si organizator të demostratave të vitit 1968 duhet të jenë më aktiv e të parët në veprimtari, se duhet punuar statutin e programin

./.

Procesi ndaj Demaçit me bashkëpunëtorët e tij nuk ishte vetëm një gjyq – ishte një provë e vendosmërisë së një brezi që nuk pranoi të heshtë. Çdo vendim gjyqësor thekson guximin dhe qëndresën e shqiptarëve për të mbrojtur idealet e tyre.

Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës
Fondi: Gjykata e Qarkut Prishtinë, viti 1975/1976



...rrjedhën e ngjarjeve. Ndojherë, një ditë të bëhej një shekull, plot ngjarje: në ag të ditës zgjohesh në mendime të detyrave të rënda, në drekë sheh se je lodhur nga fjalimet e shumta, në mbrëmje kthehesh si luftëtar i lodhur dhe me shpirt i gatshëm për të nesërmen. Vetëm disa ditë, e lëre më disa vite të tilla, të bëjnë të kujtosh se e ke kaluar tërë jetën. Po si? Kjo duhet të jetë çështje qenësore e secilit prej nesh: si kaloi kjo jetë e shkurtër dhe aq e gjatë, në të njëjtën kohë. Unë nuk do të pyetem, dhe po të lindja edhe njëherë, shtigjet i kam të njohura, me këtë përvojë që fitova pas sa kohësh do t'i qëndroja besnik vetes dhe idealit të përbashkët. Rrugë tjetër nuk ka. Ju mendoni se jam i qetë në këto meditimet e mia, se Ymer Efendia ka qenë gjithmonë i qetë, i matur në fjalë, myderiz i rutë, pos ndojherë kur nga brendia i flitnin të parët dhe i vlonte ai gjak shqiptari. Ndoshta mendoni se koha e ka bërë të veten dhe unë më jam zbutur. Çafirat!!!! Secili më i madh se tjetri. Po si mendonin a thua, nëse fare kishin kokë njeriu për të menduar, të hyjnë në shtëpinë time dhe ta dhunojnë gruan time, bijat e mia, e unë t'ua hap derën, t'u bëj temena?

Çdo gjë ishte në rregull kur ato që flisja e bëja u shkonte për huji. Shkollat e tyre i kisha kryer, flisja e shkruaja si ata *dhe tani donin të mendoja me kokën e tyre. Po, Zgatarin ku ta le?* Varret si t'i harroj? Në dhe timin të pres zotërinj? Kurrën e kurrës. Këto troje janë tonat. Në këto varre i kemi rrënjët, mbi to-filizat. Mirë se ardhtë miku, armikun copë e grimë e bëjmë.

Të furishme qenë ato kohëra, më bëhej zemra mal kur bisedoja me bashkëmendimtarët e mi të derdhur nga foletë shqiptare, kur të gjithë ishim një, ashtu si na kishte lindur nëna ilire. Sa të bukur na e la këtë tokë, me malet e larta të begatshme e krenare, fusha...

...të tyre, siç bisedonin në mes tyre. Nuk u vëja veshin se e

**Rikonstruimi antropologjik i individualitetit të Ymer Prizrenit**

dija që ata do t'i shikojnë edhe më tej dyqanet e tyre të përcjella me lepe-pekej. Isha krenar në kujtimin se të tillë ishin të paktë, fara ishte mbjellë, të korrurat vijnë më vonë. Sa për këta, të tillë ka gjithmonë, kurdoherë populli i dëmkos me këngën e çiftelisë.

... Pluhuri ngritej që nga në prag të Prizrenit. Të qëndrosh, do të thotë i dorëzohesh armikut. Ta presësh - është trathti. T'i kundërshtosh - të vrasin. Nuk është kohë për vdekje. Ati i bardhë ishte i shaluar.

...Qetësia zgjati mjaft. Nuk di çfarë ndodhi. Si në kllapi. Në shtëpinë e vogël, në Ulqin, dilnin e hynin. Ca me dukët e me unaza ari. Ca me lajme për gruan e bijat e mërguara diku në Anadoll, me bindje për kthimin e bashkimin. Të tëra këto-mbi temenatë. Shitet liria? Dikur pashë se e kisha të thyer një bri, pastaj tjetrin. Në radhë erdhi kurrizi, dhëmbët dhe, më nuk di, nuk më kujtohet...

Shumë fjeta, dhe ishte koha të zgjohem.

Bie shi. Bistrica ende sjell ujë të dëlirë. Ndërtesa e Lidhjes sonë ngritet krenare. I sheh, Abdyl, këto fytyra të qeshura, këto kurora lulesh që kanë ardhur të na përshëndetin.

Shpalo, Kararnamen, Abdyl, shpalo. Ditë e re agoi.

Edi Shukriu- HOTI



ORGAN I LIDHJES SOCIALISTE TË POPULLIT PUNONJËS TË KOSOVËS

LIDHJA E PRIZRENIT

*Ndërtesa e Lidhjes së Prizrenit*

Në vitin e njëqindtë, lajmi del në faqet e "Rilindjes" dhe hyn në regjistrin zyrtar: program, fjalime, foto, përkujtime. Gazeta bëhet ura që e sjell temën nga periferia e bisedave private në qendër të hapësirës publike. Ky kalim nuk ishte thjesht ndryshim i tonit, por i statusit të vetë kujtesës – një normalizim i përkujtimit brenda institucioneve dhe një gjuhë e re publike për historinë.

**Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës**
**Fondi: Gazeta Rilindja**



E MËRKURË
7 QERSHOR
1978
PRISHTINË
Çmimi 2 din.

RILINDJA

ORGAN I LIDHJES SOCIALISTE TË POPULLIT PUNONJËS TË KOSOVËS

KREMTIMI I 100-VJETORIT TË LIDHJES SË PRIZRENIT

REVOLUCION NACIONAL DHE POLITIK

FJALA E PAJAZIT NUSHIT

PJESËMARRËSIT

KREMTIMI I 100-VJETORIT TË LIDHJES SË PRIZRENIT

LETËRSIA E RILINDJES DHE LIDHJA E PRIZRENIT

LIDHJA SHQIPTARE E PRIZRENIT — FAKTOR KRYESOR INTEGRUES

SHPEJTIMI I JETËS SË VONUAR TË SHQIPTARËVE

PUBLICISTIKA DHE OPINIONI

Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës
Fondi: Gazeta Rilindja



P.nr.138/8o.-

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E QARKUT NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtari Isak N+shevci, kryetar, gjyqtari Ymer Osaj dhe gjyqtarët porotë Sabit Sejdiu, Maksimoviq Dojqin dhe Gani Fushtica, anëtarë, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Bedrije Kasumi, punëtore e kësaj gjykate, në çështjen penale të akuzuarëve Ymer Grainca, nga fshati Cërnillë, të cilën e mbronë sipas detyrës zyrtare Jusuf Hakaj av. nga Prishtina, për veprën penale bashkimi për veprimtari armiqësore nga neni 136 al.1 lidhur me nenin 114 të LPJ, Ibrahim Shala, nga Mushitishta, të cilin e mbronë Hasan Kryeziu av. nga Prishtina, për vepër penale bashkimi për veprimtari armiqsore nga neni 136 al.1 lidhur me nenin 114 të LPJ, Emrush Xhemajli, nga fshati Komogllavë, të cilin e mbronë sipas detyrës zyrtare Zeqi Arni, av. nga Prishtina, për veprën penale propagandë armiqësore nga neni 133 al.2 të LPJ, Xhabir Morina, nga Ferizaji, të cilin e mbronë sipas detyrës zyrtare Latif Krasniqi, av. nga Prishtina, për vepër penale propagandë armiqësore nga neni 133 al.2 të LPJ dhe Besim Baraliu, nga fshati Bukosh, të cilin e mbronë sipas detyrës zyrtare Latif Krasniqi, av. nga Prishtina, për veprën penale propagandë armiqësore nga neni 133 al.1 të LPJ, të akuzuar me aktakusën e Prokkurorisë publike të qarkut në Prishtinë PP.nr.1o1/79 të dt. 9.maj 198o, pas mbajtjes së seancës kryesore publike në praninë e të akuzuarëve, mbrojtësve të tyre dhe përfaqësuesit të akuzës publike, zëvendës prokurorit publik të qarkut Miftar Jasiqi, me 13.qershor 198o mori dhe publikisht shpalli këtë

./.



2.-

A K T G J Y K I M

Të akuzuarët:

1.-IMER GRAINCA, nga i ati Zejnullahu dhe e ëma Elifja, e gjinisë Thaqi i lindur më 1o.mars 1961, në fshatin Cërnillë, ku edhe jeton, shqipëtar, shtetas i RSFJ, student, i pamartuar, ka kryer Gjimnazin, obligimin ushtarak nuk e ka rregulluar, mbahet në EU pranë KK Ferizaj, i gjendjes së dobët ekonomike, i pagjykuar, kundër tij nuk shvillohet procedurë tjetër penale, gjendet në paraburgim prej 11.nëntor 1979.

2.-IBRAHIM SHALA, nga i ati Isufi dhe e ëma Ajshja, e gjinisë Abazi, i lindur më 11.janar 196o, në fshatin Mushitishtë, ku edhe jeton, shqipëtar shtetas i RSFJ, nxënës i klasës së IV të QAMO "Jeta e Re" në Suharek, i martuar, obligimin ushtarak nuk e ka rregulluar, mbahet në EU pranë KK Suharek, i gjendjes së mesme ekonomike, i pagjykuar, kundër tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, gjendet në paraburgim prej 19.nëntor 1979.

3.-EMRUSH XHEMAJLI, nga i ati Muharremi dhe e ëma Hasinja, e gjinisë Fazliu, i lindur më 1.V. 1959 në fshatin Komogllavë, ku edhe jeton shqipëtar, shtetas i RSFJ student, i pamartuar, më parë ka kryër Gjimnazin, obligimin ushtarak nuk e ka rregulluar, mbahet në EU të KK Ferizaj, i gjendjes së dobët ekonomike, më parë i pagjykuar, kundër tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, gjendet në paraburgim prej 11.nëntor 1979.

Në fund të viteve '70 dhe në prag të 1981-s, shteti i vuri kufij të rreptë fjalës dhe organizimit. Në aktakuzat dhe aktgjykimet e kohës, termi "veprimtari armiqësore" përfshinte një spektër të gjerë sjelljesh: nga shpërndarja e pamfleteve dhe mbajtja e literaturës "të ndaluar", te organizimi i rretheve studentore ose thjesht artikulimi publik i pakënaqësisë. Dënimet – burgim, konfiskim materiali, ndjekje e gjatë policore – synonin të ftohnin hapësirën publike.

**Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës**
**Fondi: Gjykata e Qarkut Prishtinë, viti 1980**



3.-

4.-XHABIR MORINA, nga i ati Haliti dhe e ëma Hanifja, e gjinisë Musliu, i lindur më 3.qershor 1959, në Gilan, tani jeton në Ferizaj, shqipëtar, shtetas i RSFJ, student i Fakultetit juridik, i pamartuar obligimin ushtarak nuk e ka rregulluar, mbahet në EU pranë KK Ferizaj, i gjendjes së dobët ekonomike, i pagjykuar, kundër tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, gjendet në paraburgim prej 11.nëntor 1979.

5.-BESIM BARALIU, nga i ati Rrahmani dhe e ëma Rrahimja, e gjinisë Gashi, i lindur më 26.shkurt 1959 në fshatin Bukosh, ku edhe jeton, shqipëtar, shtetas i RSFJ, student i vitit të II-të të Fakultetit filozofik në Prishtinë, i pamartuar, shërbimin ushtarak nuk e ka rregulluar, mbahet në EU të KK Suharek, i gjendjes së mesme ekonomike, i pagjykuar, kundër tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, gjendet në paraburgim prej 5.dhjetor 1979.

JANË FAJTORË

Dhe ato:

1.- I AKUZUARI IMER GRAINCA

Sepse për të kryer vepra penale kundër bazës së rregullimit shoqëror socialist e vetëqeverisës dhe sigurisë së RSFJ dhe të cenimit kundërrevolucionar të rregullimit shoqëror të drejtuar në përmbysjen e pushtetit të klasës punëtore e njerzve punonjës dhe shkatërrimin e bashkim vllazërimit e të barazisë së kombeve e kombësive, si dhe të ndërimit antikushtetutar të rregullimit shoqëror, gjatë vi...
në Ferizaj, si organizator, formoi grupin e...
me të akuzuarët Nuresh Xhemajlin dhe Xhabir...
me qëllim që të punojnë dhe veprojnë armiqë...
RSFJ, me detyrë që në rastin e ndonjë kriz...

./.



4.-

allavi ta gfrytëzojnë rastin për ndryshimin e sistemit shoqëror socialist e vetëqeverisës, dhe njiherit marrin për sipër që të shkruajnë materiale propagandistike si pamflete e parolla kundër sistemit socialist vetëqeverisës të RSFJ, gjatë vitit 1979 në Prishtinë me qëndrimet e tija përfitoi të akuzuarin Besim Baraliun nga fshati Bukosh, dhe shokun e tij Ramadan Veliun, me të cilët takohen së pari në Prishtinë e në një grup edhe me përsonat tjerë merren vesh për veprimet armiqësore të mëtejshme dhe për përfitimin dhe zgjerimin e grupit me antarë të ri, në muajin qershor 1979, në Prishtinë, në banesën e tij, nëpërmes të akuzuarit Besim Baraliut, kontaktoi me të akuzuarin Ibrahim Shalën, udhëheqës i grupit armiqësor nga Suhareka, me të cilin këmbyen përvojat e veprimeve armiqësore, shkëmbejnë materiale propaganditstike si gazeta "Bashkimi", pamflete e Rregullat për punën armiqësore kundër RSFJ të organizatave ilegale "Fronti i Kuq" dhe "Zëri i Kosoves" që punojnë dhe veprojnë në Republikën Federale të Gjermanisë, në qershor të vitit 1979 së bashku me të akuzuarin Nuresh Xhemajlin hartojnë projektin e programit të punës dhe veprimtarisë të mëtejme të organizatës në formin të cilën deshtën ta quajnë me emrin "Lëvizja për çlirimin social dhe nacional të Kosovës", nga i akuzuari Ibrahim Shala e mori projektin "Programi i shkurtë mbi punën organizative" të grupit të tij në të cilat projekte pos tjerash parashihet veprimtaria ilegale e organizatës në themelim të grupit nga Suhareka, zgjedhja e udhëheqësisë dhe udheheqësit, vetit e antarëve dhe angazhimi i tyre për përfitimin e antarëve të ri dhe krijimin e kushteve për ngritjen e revolucionit, në mjin gusht 1979 nëpërmes të akuzuarit Ibrahim Shalës në fshatin Cërnillë, takohet me Ibrahim Kelmendin, nga rrethi i Pejës, punëtor i punësuar

./.



5.-

përkohësisht në RF të Gjermanisë, i cili e njohtoi për ekzistimin dhe veprimin e organizatës ilegale "Zëri i Kosoves" që punon dhe vepron në RF të Gjermanisë kundër RSFJ, e pastaj bisedojnë për bashkëpunimin e mëtejmë të këtyre organizatave, në ndërmarrjen e aksioneve konkrete kundër sisitemit socialist vetqeverisës të RSFJ, në tetor të vitit 1979 në Cërnillë organizon mbledhjen e grupin e pesë anëtarëve në të cilën e shqyrtojnë çështjen e bashkimit dhe veprimit me organizatat ilegale "Zëri i Kosoves" dhe "Fronti i Kuq" që punojnë dhe veprojnë nga jasht, ku me atë rast është vendos për bashkëpunim për çka pastaj i akuzuari Imer ka shkruar një letër për t'ia dërguar Ibrahim Kelmendit dhe njohtuar për vendimin për përkrahje dhe bashkëpunim, e po në këtë mbledhje i akuzuari Imer Grainca zgjedhet për udhëheqës.-

-me çka ka kryer veprën penale bashkimi për veprimtari armiqësore nga neni 136 al.1 lidhur me nenin 114 të LPJ.

2.- I AKUZUARI IBRAHIM SHALA

Sepse për të kryer vepra penale kundër bazës së rregullimit shoqëror socialist e vetëqeverisës dhe sigurisë së RSFJ dhe të cenimit kundërrrevolucionar të rregullimit shoqëror të drejtuar në përmbysjen e pushtetit të klasës punëtore e njerzve punonjës, shkatërrimin e bashkim vllazërimit e të barabarësisë së kombëve e kombësive si dhe të ndërrimit kundërkushtetutar të rregullimit shoqëror, kah fillimi i vitit 1979, në Suharekë, si organizator, formoi grupin armiqësor të përbërë prej shtatë anëtarësh, u foli për qëllimin e formimit të grupit në drejtim të veprimit armiqësor kundër sistemit socialist vetqeverisës të RSFJ, i furnizoi me literaturë propagandistike dhe

Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës
Fondi: Gjykata e Qarkut Prishtinë, viti 1980

**Shënime:**

**Shënime:**

**Shënime:**